



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/55

Datë: 14.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2009, mori

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni qeveritar për organizimin e kremtimit të Festës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
  - a) Z. Ramë Manaj - zëvendëskryeministër - kryesues
  - b) Z. Hajredin Kuçi - zëvendëskryeministër - anëtar
  - c) Z. Ahmet Shala - ministër - anëtar
  - d) Z. Enver Hoxhaj - ministër - anëtar
  - e) Z. Valton Beqiri - ministër - anëtar
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/55

Datë: 14.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2009, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) Euro, për organizimin e krenimeve lidhur me një vjetorin e Pavarësisë së vendit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendim ndahen nga fondi "Rezervat e Paparashikuara të Qeverisë" dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, kodi 10700, në kategorinë mallra dhe shërbime.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë